

VENDIM
Nr.535, datë 4.8.2006

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, TË INSTITUTIT TË STUDIMIT TË TOKAVE
DHE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të ndërtesës së Institutit të Studimit të Tokave, që janë në përdorim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Mjediseve të lira të Institutit të Studimit të Tokave, kati përdhe dhe i dytë, që janë në administrim të këtij të fundit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Instituti i Studimit të Tokave te Ministria e Financave, për t’u përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Mjediseve të godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, katet përdhe, i dytë, i tretë dhe i katërt, që janë në administrim të kësaj të fundit, t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave te Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për t’u përdorur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit u ndalohej ta ndryshojnë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, ta tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për të përballuar shpenzimet e transferimit, të përdorë fondet e dhëna në buxhetin shtesë, për vitin 2006.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Instituti i Studimit të Tokave dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha